



# FIF – Rritja e Qëndrueshme e SME-ve – CFFA

Shteti:	SHQIPËRI
Numri i Projektit:	56448
Sektori i Biznesit:	Kredi depozituese (banka)
Tipi i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	Institucion Financiare
Data e Aprovimit:	29 Korrik 2025
Statusi:	Miratuar
Publikimi i PSD:	08 Gusht 2025
<i>Sipas sessonit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për Projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtoreve ka deleguar autoritetin e miratimit, PSD duhet të publikohet në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit pa kundërshtime për një vend anëtar të Bankës në përputhje me Nenin 13 (iii) të Marrëveshjes Themeluese të BERZH.</i>	

## Përshkrimi i Projektit

Një hua e pa-siguruar deri në shumën EUR 2.0 milionë për Crimson Finance Fund Albania (CFFA) për të ofruar nën-hua për bizneset mikro, vogla dhe të mesme (MSME) në Shqipëri, nëpërmjet Programit të Rritjes së Qëndrueshme të SME-ve.

## Objektivat e Projektit

Fondet e Bankës do të përdoren për të dhënë hua për financimin e investimeve në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri që do të ndihmojnë në përmirësimin e konkurrencës dhe përafrimin me standarde teknike në përputhje me direktivat e BE-së dhe standarde tjetra të njoitura ndërkombëtare. Të paktën 70% e investimeve do të jenë për teknologjitë GET. Nën-projektet do të përzgjidhen sipas kriterieve të përputhshmërisë teknike dhe financiare të përcaktuara në Deklaratën e Politikave për Programin e Rritjes së Qëndrueshme të SME-ve.

## Ndikimi në Tranzicion

ETI 60

Projekti do të kontribuojë në objektivat e përgjithshme të Programit dhe do të mbështesë cilësitetë **Konkurruese** dhe **e Gjelbër** të Ndikimit në Tranzicion. Cilësia Konkurruese do të mbështetet nga: (i) rritja e konkureshmërisë së SME-ve; dhe (ii) prioritizimi i investimeve që rezultojnë në përputhje me Direktivat e BE-së dhe standarde tjetra përkatëse ndërkombëtare. Projekti do të ndihmojë gjithashtu investimet në teknologjitet e gjelbra që do të nxisin tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër të qëndrueshme për mjedisin, me karbon më të ulët dhe rezistente ndaj klimës, duke mbështetur kështu cilësinë e Gjelbër.

## Informacioni për Klientin

CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SHPK

CFFA është një institucion mikro-financiar i themeluar në vitin 2015, i licensuar dhe rregulluar nga Banka e Shqipërise (BSH). CFFA u ofron klientëve të saj të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme tre lloje produktesh: hua (në formën e kredivë afatgjata dhe linjave të kredisë; këto përbëjnë 86.2% e portofolit të saj total në fund të tremujorit të parë 2025), qira financiare (2.8%) dhe faktoring të drejtpërdrejtë (11.0%).

## BERZH Përbledhja Financiare

EUR 2,000,000.00

## Kosto Totale e Projektit

EUR 2,000,000.00

## Vlera e shtuar

Projekti kombinon financimin e nevojshëm afat-mesëm me mbështetjen teknike dhe incentivat e investimeve nën një paketë që promovon investimet e gjelbra të cilat përmirësojnë konkurrencën e MSME-ve.

## Përbledhja Mjedisore dhe Sociale

E kategorizuar Institucion Financiar (ESP 2024). CFFA është një institucion mikrofinanciar dhe një klient ekzistues i BERZH-it. Klienti aktualisht po përbush Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (ESR) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas ekspozimeve të tij ekzistuese ndaj BERZH-it. Sipas këtij Programi për Rritjen e Qëndrueshme të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), nënprojektet e pranueshme do të mbështesin nën-kreditë e mikrofinancimit për të ndihmuar në financimin e investimeve në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri, të cilat ka të ngjarë të kenë rrezik të ulët

mjedisor dhe social (E&S). Kontrolli i duhur mjedisor dhe social është ndërmarrë përmes një shqyrtimi të pyetësorit të plotësuar nga klienti, duke përfshirë dokumentacionin mbështetës dhe komunikimin pasues me klientin. CFFA ka një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social (ESMS), i cili konsiderohet i përpjesëtuar me profilin e rrezikut të nënprojektit të pranueshëm. CFFA duhet të mirëmbajë Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social të saj për të vlerësuar, menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë efektive rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale, politikën e burimeve njerëzore (HR), mekanizmin e brendshëm të ankesave, procedurat e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (H&S) në përputhje me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (ESR) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas ESP-së (2024). Kjo përfshin pajtueshmërinë me listën e përjashtimeve Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, zbulimin publik të detajeve të ESMS-së së saj dhe përputhshmërinë me udhëzimet përkatëse të BERZH-it për institucionet financiare. Nën-huamarrësit e financuar nga klienti duhet të jenë në përputhje me ligjet kombëtare mjedisore, sociale, shëndetësore, të sigurisë dhe të punës në fuqi. CFFA vazhdon të paraqesë raporte vjetore Mjedisore dhe Sociale te BERZH, duke detajuar pajtueshmërinë me kërkesat e BERZH-it, rezultatet e shqyrtimit të nënprojekteve dhe çdo incident material Mjedisor dhe Social. Nëse financimi i BERZH-it përdoret për nënprojekte të energjisë së rinnovueshme, këto duhet të përbushin kriteret e pranueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it për burimet e rinnovueshme, si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në Deklaratën e Politikave.

## Bashkëpunimi Teknik

**Bashkëpunimi Teknik** do të përfshijë mbështetje nga konsulenti i programit që do të ndihmojë në zbatimin, marketingun dhe monitorimin e Programit dhe do të kryejë një vlerësim të veçantë të zbatimit teknik të investimeve nga huamarrësit përpara disbursimit të incentivëve. Burimi për fondet e Bashkëpunimit Teknik në nivel programi është Fondi Special i Aksionerëve të BERZH, Danimarka si dhe Luksemburgu, Norvegjia, Zvicra(SECO) dhe SHBA nëpërmjet Fondit të Ndikimit të Biznesit të Vogël.

Pjesa e grantit që **nuk përfshin Bashkëpunim Teknik** kundrejt financimit të BERZH do të jetë deri në 10% për nën-operacionet. Burimi për financimin jo- Teknik në nivel programi është Norvegjia, Luksemburgu, Zvicra(SECO) dhe SHBA nëpërmjet Fondit të Ndikimit të Biznesit të Vogël, si dhe Danimarka.

Burimi për fondet e Bashkëpunimit Teknik dhe për fondet që nuk do të përdoren për Bashkëpunim Teknik për këtë nën-operacion të veçantë me CFFA është **SECO** nëpërmjet Fondit të Ndikimit tek Bizneset e Vogla.

## Informacion Kontakti i Kompanisë

Dorin Rama

[dorin.rama@cffa.al](mailto:dorin.rama@cffa.al)

+355 4 450 03 85

<https://cffa.al/en/>

Njësia administrative nr 9, rruga Çerçiz Topulli, Pallati Sostige, Nr.14, Kati 0, Tiranë, Shqipëri

## Përditësimi i fundit i PSD-së

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë cliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, viziton [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkuesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit të përdorur dëshironi përmes njësive të përgjegjësisë sociale. PMS është një dokument i cili përmes të cilës BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashut informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtronë kontolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme

integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korruption dhe shkelje në projektet e finançuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërges publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.